



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2363 prot.

Gramsh ,më 05/06 /2024

**VENDIM**

Nr. 44 , datë 31 . 05 .2024

**PËR**

**Propozim për shpalljen “Dëshmor i Atdheut ” të të ndjerit z.Partizan Ferit Kasmi.**

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024 , mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1, shkronja (b) dhe (d), si dhe neni 54 shkronja (k), Ligji nr. 112/2013 Për “ Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut” ,Rregullojta e Funksionimi të Këshillit Bashkiak neni 47 dhe VKM nr.86/2014 datë 10.12.2014 :

**VENDOSI:**

1. Propozimin Komisionit të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, shpalljen e **z.Partizan Ferit Kasmi “Dëshmor i Atdheut”** me motivacionin *“Rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial të lirisë e pavarësisë së Shqipërisë dhe arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve Shqiptare nga ushtritë e huaja dhe qëllimeve shoviniste të tyre”*
2. Një kopje ti dërgohet Komisionit Qëndror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut pranë Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Këshillit dhe Anëtarët e Komisionit Këshillimor për Dhënien e Titujve të Nderit.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Xhulia GJINI**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**  
**Enis ZANI**

Sek. Këshillit  
ygy

2363/  
3.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË  
DELEGUARA

Nr. 663/prot.  
1

Elbasan, më 12.6.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.44 datë 31.05.2024, " Propozim për shpalljen 'Dëshmor i Atdheut' të të ndjerit zotit Partizan Ferit Kasmi ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Në mungesë dhe me Urdhër  
NËNPREFEKTI I GRAMSHIT

Albert CECI

